



Our school our diversity

your story in 60 seconds

Komisariati i Lartë për Pakicat Kombëtare i OSBE-së shpall video konkurs

Shkolla jonë, diversiteti ynë: Rrëfimi juaj në 60 sekonda

në mesin e fëmijëve të moshës shkollore dhe të rinjve. Qëllimi i këtij video konkursi është për të rritur ndërgjegjësimin e rolit të arsimit në parandalimin e konflikteve me rastin e 20-vjetorit të fillimit të rekomandimeve të para dhe pionere të KLPK (HCNM) mbi të drejtat arsimore të pakicave kombëtare.

Bashkohu me ne në ngritjen e vetëdijes për rolin e arsimit në parandalimin e konflikteve, duke na treguar video rrëfimin tuaj në lidhje me diversitetin në shkollën tuaj.

Tre videot më të mira do të fitojnë çmime dhe gjithashtu do të prezantohen me rastin e festimit të përvjetorit në Hagë, Holandë më 20-21 prill 2016. Videot e dërguara do të vendosen në web faqen e KLPK OSBE-së si dhe dhe webfaqe të tjera të ngjajshme.

KUSH: Komisarati i Lartë për Pakicat Kombëtare i OSBE-së është institucion i pavarur i OSBE-së, i themeluar në vitin 1992 me një mandat për të siguruar paralajmërim të hershëm dhe veprime të hershme, kur tensionet e mundshme që lidhen me pakicat kombëtare mund të nxisin konflikte midis apo brenda shteteve.

ÇKA: Regjistroni një videoklip maksimalisht një minutësh duke na i rrëfyer një histori në lidhje me diversitetin në shkollën tuaj. Bota e sotme është gjithnjë e më shumë multilingale (multigjuhësore) dhe multikulturore. Si ju duket juve dhe shokëve tuaj kjo botë? Çfarë roli luan arsimit në të? Sa ka diversitet kulturorë në shkollën tuaj dhe cila është përvoja juaj me të? A e transformon arsimit diversitetin në një mundësi?

AFATI: 4 - 31 Mars 2016, 11:59 pm (UTC+01:00).

PJESËMARRJA: Të rinjtë të moshës mes 12 dhe 18 vjeçe, individualisht ose në grupe të vogla.

NDARRJA E ÇMIMEVE: Komisarati i Lartë për Pakicat Kombëtare i OSBE-së do të ndajë çmime për tre video. Çmimi i parë është një video kamerë, çmimin e dytë një tabletë dhe çmimi i tretë një çantë shpine me panele diellore.

SI: Videot mund të incizohen duke përdorur kamerën e telefonit tuaj celular ose pajisje të tjera, mundësisht të filmuara horizontalisht (në dimenzion të pejsazhit). Filmi nuk duhet të jetë më i gjatë se një minutë!

GJUHA: Gjuha nuk paraqet kufi. Videot mund të incizohen në çfarëdo gjuhë, por duhet të jetë e kuptueshme për shikuesit të cilët nuk e flasin gjuhën e përdorur në video. Videoklipet që përfshijnë përdorimin kreativ të gjuhës vizuale, muzikës, tingujve dhe ideve të tjera të interesante janë më të mirëpritur.

PARAQITJA: Dërgoni videon tuaj maksimalisht një minutëshe nëpërmjet

- E-mail drejtuar: videocontest@osce.org (Shënim: Mos e bashkangjitni video fajlin në e-mail, por dërgoni linkun ku është ngarkuar videoja, p.sh në Dropbox, WeTransfer, MEGA apo TransferBigFiles)
- Whatsapp: Shkolla jonë, Diversiteti ynë në numrin +31641644344
- Viber App: Shkolla jonë, Diversiteti ynë në numrin +31641644344
- Line App: Shkolla jonë, Diversiteti ynë në numrin +31641644344

Ju lutemi gjithashtu, gjatë dërgimit të videos dërgoni edhe informacionet e mëposhtme:

- Emrin tuaj të plotë(Emrat)
- Datën e lindjes (Datat)
- E-mail kontaktin
- Numrin kontaktues të telefonit
- Foto personale apo grupe
- Shtetin, qytetin dhe emrin e shkollës

Ju lutemi rruani skedarin(fajllin) origjinal të videos në telefonin ose foto aparatit tuaj. Në rast se videoja juaj do të zgjidhet për t'u shfaqur në eventin e përvjetorit, ne do t'ju kontaktojmë për të rregulluar transferimin e skedarit (fajllit) origjinal.

KUSHTET: Të gjithë pjesëmarrësit bien dakord në përputhje me të, dhe të gjitha parashtrirat u nënshtrohen: Kushteve të Aplikimit për këtë garë në www.osce.org/hcnm/225526.

NJOFTIMI: Juria do të shqyrtojë të gjitha videot e paraqitura dhe do të informojë prodhuesit e incizimeve fituese përmes e-mailit deri më 15 prill 2016.

WEBFAQJA: www.osce.org/our-school-our-diversity

Rekomandimet e Hagës lidhur me të Drejtat e Shkollimit të Pakicave Kombëtare të promovon respektimin e të drejtave të pakicave kombëtare në arsim, mundësi të barabarta arsimimi për personat që u përkasin pakicave kombëtare dhe edukimin si një mjet për integrimin e shoqërive.

"Arsimimi është i nevojshëm jo vetëm për të siguruar trajnim rigoroz akademik dhe teknik, por ai është gjithashtu i nevojshme për të rrënjësuar vlera të tilla si toleranca, pluralizmi, anti-racizmi dhe harmonia ndërkombëtare dhe ndërkombëtare." (Rekomandimet e KLPK Hagës)